



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

Nr 3689/5 Prot

Vau Dejes, 02.07.2025

Lënda: Kërkesë për njoftimin për publikim

Drejtuar : Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe IT

Mbështetur në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës “Për fillimin e procedurës për organizimin e eventit të 16 gushtit (skene dhe fonit)” *kërkojmë nga ana juaj publikimin e njoftimit ne faqen zyrtare WEB , si më poshtë :*

NJOFTIM

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; të Ligjit nr 162/2020 “ Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM nr Nr. 768, datë 15.12.2021, “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”; VKB nr 84, dt 23.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesem 2025-2027 të Bashkisë Vau Dejës”, *Bashkia Vau Dejës njofton të interesuarit/konkurrentet se kërkon të organizojë një event në datën 16 gusht, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme*

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

KRITERET E VEÇANTA

1. Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

N R. 1	FESTA E 16 GUSHTIT	Specifikimet
1	Koncert festiv me pjesëmarrje të kengetareve të njohur (4 kengetar)	Koncert festiv me pjesëmarrje të kengetareve të njohur kombëtar. Në total duhet të mbulohet së paku 150 minuta spektakel. i përfshirë prezantuesi.
2	FV skenë për rastin (6X6x0,7 m)	F.V. skenë outdoor për rastin (6X6x0,7 m). Skena mund të jenë në pronësi apo të marra me qira nga OE për aktivitetin përkatës me një sipërfaqe totale jo më pak se 36 m ² , me gjatësi 6mX6m dhe lartësi 0.7 m.

3	Foni	Aparatura qendër zëri rreth 4000ë për të përmbushur akustikëne kërkuar Si dhe mbushur të gjithë sheshin me volum, të jetë i pranueshëm në audiencë si dhe për të arritur atë që kërkojnë artistët. Fonia është termil përgjithshëm I sistemit audio dhe aty përfshihen të gjitha setet e nevojshëm si artopolante(bokse) speaker, monitor, mikrofon, pult fuqie, pult mikser, kamaleca mikrofonash dhe boksesh, stabilizator dhe kabul për mikrofonat dhe lidhje e bokseve me aparatura mikser dhe fuqie, lap-top, etj
4	Ndricimi i skenes dhe ndricimi i ambientit rrethues ku do të zhvillohet aktiviteti (Fusha Sportive Bushat)	Ndricimi i skenes (Prozhektor, Robot, Tymese)
SHUMA 1		

- **Vlera e parashikuar në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës për këtë event, është 2.500.000(dy million e peseqind mijë)lekë pa tvsh.**
- **Eventi organizohet me datë 16.08.2025, ora 20:00**
 - **Kërkesat për pjesmarrje do të paraqiten, pranë sekretarisë së Bashkisë Vau Dejës me zarfe të mbyllura, me shënimin të mos hapet përpara dates 11.07.2025, ora 10:00.**
 - **Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesmarrje është data 11.07.2025, ora 10:00, në çdo rast subjektet e interesuar mund të bëjnë kërkesë për informacion apo sqarime në rrugë elektronike në adresën dorina.lini@vaudejes.gov.al**

KOMISIONI

Dorina Lini

Ersilda Preka

Stefani Jaku